LIGJ
Nr. 105/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 53/2025, "PËR PATENTAT, MODELET E PËRDORIMIT DHE CERTIFIKATAT E MBROJTJES SHTESË"

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 53/2025, "Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë" bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 102 të ligjit bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

"2. Të drejtat ekskluzive të siguruara nga patenta nuk shtrihen mbi një produkt që është objekt i patentës, pasi ky produkt është hedhur në treg në territorin e Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e tij.";

b) Pika 2 ndryshohet dhe rinumërtohet si pika 3, si më poshtë:

"3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse ka baza të mbështetura në ligj ose në rregullore për mbajtësin e patentës të ndalojë tregtimin e mëtejshëm të produktit.";

c) Pika 3 ndryshohet dhe rinumërtohet si pika 4, si më poshtë:

"4. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe për të drejtat ekskluzive të fituara nga certifikata e mbrojtjes shtesë.".

Neni 2

Në nenin 165 të ligjit bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Fjalia ekzistuese rinumërtohet si pika 1 me këtë përmbajtjen:

"1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.";

b) Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

"2. Pika 2 e nenit 102 të këtij ligji hyn në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.10.2026.

Shpallur me dekretin nr. 568, datë 26.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj